



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM**

**Nr. i Dokumentit: 22.13.1-2013-08**

**RAPORTI I AUDITIMIT**  
**PËR PASQYRAT FINANCIARE TË KOMUNËS SË RAHOVECIT**  
**PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2013**

**Prishtinë, Qershor 2014**

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës. Auditori i Përgjithshëm, Lage Olofsson, është kreu i ZAP-it, i cili ka rreth 145 të punësuar. Auditori i Përgjithshëm dhe ZAP janë të pavarur dhe çertifikon rreth 90 Pasqyra Vjetore Financiare çdo vit, ndërsa mund të ndërmarr edhe forma të tjera të auditimit.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhim të shëndoshë financiar në administratë publike. Ne do të kryejmë auditime cilësore në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit të sektorit publik dhe praktikat e mira evropiane. Ne do të ndërtojmë besim në shpenzimin e fondeve publike. Ne do të luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe palëve të tjera të interesit në rritjen e llogaridhënies publike.

Raportet e nxjerra nga ZAP promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien pasi që ato ofrojnë bazë për ti kërkuar llogari menaxherëve të çdo organizate buxhetore.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit dhe raportin mbi Pasqyrat Vjetore Financiare të Komunës së Rahovecit në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm, Qerkin Morina, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nën menaxhimin e Drejtorit të Auditimit, Florim Beqiri, i mbështetur nga, Blerina Krasniqi (Udhëheqës Ekipi), Ardita Jetullahu dhe Elvir Krasniqi.

## TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme .....	4
1 Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia .....	7
2 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm .....	8
3 Rekomandimet e vitit paraprak .....	13
4 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli .....	14
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP .....	30
Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak.....	33

## Përmbledhje e përgjithshme

### Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore të Komunës së Rahovecit (në tekstin e mëtejme: Komuna) për vitin 2013 – i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Falënderoj Kryetarin e Komunës dhe stafin e tij për ndihmën e tyre gjatë procesit të auditimit.

Ekzaminimi i Pasqyrave Vjetore Financiare për vitin 2013 u ndërmor në përputhje me Standardet e njohura Ndërkombëtare të Auditimit në Sektorin Publik . Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ne menduam se ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e ndërmarrë është paraqitur në Memon e Planifikimit të Auditimit, të datës 21/10/2013.

Auditimi ynë është fokusuar në:

- Pasqyrat Vjetore Financiare – pajtueshmërinë me kornizën e raportimi dhe rreziqet domethënëse për Pasqyrat Vjetore Financiare të theksuara në Memon e Planifikimit të Auditimit;
- Veprimet e ndërmarra ndaj rekomandimeve tona për vitin 2012 dhe atyre të mëhershme; dhe
- Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm të komunës (duke përfshirë menaxhimin dhe ekzekutimin e buxhetit)

Niveli i punës së kryer nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm për të përfunduar auditimin për vitin 2013 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti.

## Opinion

Shtojca I shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm është:

Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare *prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.*

Si *Theksim i çështjes* Regjistri i Pasurive Fikse ende nuk është i plotë dhe i saktë, pasi që regjistri i pasurive jokapitale ishte nënvlerësuar për 363,245€. Po ashtu komuna kishte bërë keq klasifikimin e shpenzimeve në vlerë 106,563€, ku nga kodi i kapitaleve, komuna kishte bërë pagesa për subvencione (29,980€) dhe për mallra dhe shërbime (76,583€). Regjistri i pasurive fikse dhe keq klasifikimi ekonomik i shpenzimeve nuk ka ndikim në ndonjërin prej dy Pasqyrave Vjetore Financiare ('Pranimet dhe Pagesat në Para të Gatshme' dhe 'Krahasimi i Buxhetit me Shumat Aktuale'), në pajtim me SNKSP në bazë të kontabilitetit të parasë së gatshme. **(SNISA 200 Opinion i Pamodifikuar me Theksim të Çështjes).**

## Konkluzioni i përgjithshëm

Bazuar në detajet e paraqitura në secilën pjesë të këtij raporti, konkluzioni ynë i përgjithshëm është se:

Menaxhmenti i Komunës kishte dizajnuar sistemin e kontrollit të brendshëm, por këto kontrole nuk kishin funksionuar në disa fusha të rëndësishme të menaxhimit financiar. Këto duhet në vazhdimësi të monitorohen për t'u siguruar se janë duke funksionuar siç duhet. Në vazhdim po i paraqesim fushat në të cilat janë vërejtur mangësi:

- Edhe pse Pasqyrat Vjetore Financiare kishin adresuar shumicën e kërkesave për prezantim, Pasqyrat Vjetore Financiare të paraqitura për auditim kishin disa pasaktësi. Disa janë ndryshuar në versionin final, megjithatë menaxhmenti zgjodhi t'i linte disa zëra të pakorrigjuara, kur ishte fjala tek paraqitja e plotë e pasurive;
- Shumica e rekomandimeve të vitit 2012 dhe të viteve të mëparshme nuk janë implementuar ende. Kjo do të rezultojë në mosfunksionimin e kontroleve të brendshme dhe vlerë të dobët për paranë;
- Mungesa e një regjistri të plotë të pasurive, pasqyron dobësitë në kontrollet e zbatuara nga menaxhmenti për të konfirmuar plotësinë dhe saktësinë e pasurive; dhe
- Edhe pse ne arritëm të merrnim siguri nga kontrollet efektive të menaxhmentit në disa fusha të pasqyrave, vlerësimi ynë për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin ka nxjerr në pah se në disa fusha të rëndësishme të veprimtarisë ekzistojnë dobësi domethënëse. Kjo veçanërisht ka ndodhur në planifikimin dhe inkasimin e dobët të

të hyrave, në prokurim, ku kontratat janë lidhur dhe menaxhuar dobët; në shpërndarjen e subvencioneve pa u bazuar në rregulloren e brendshme dhe pa dokumentacion mbështetës, mos raportim mujor të obligimeve të papaguara, cilësi jo e mirë e raporteve të Njesisë së Auditimit të Brendshëm si dhe mosfunksionim i komitetit të auditimit.

### **Rekomandimet tona kryesore për Kryetarin e Komunës janë si në vijim:**

- Duhet të sigurojë që në procesin e hartimit të Pasqyrave Vjetore Financiare për vitin 2014 të përfshihet formalisht edhe rishikimi nga menaxhmenti i draft pasqyrave, me fokus të veçantë në fushat që konsiderohen me rrezik të lartë për gabime dhe/ose fushat ku gabimet janë identifikuar në vitet e mëparshme;
- Duhet të sigurojë që plani i veprimit, i rishikuar të përcaktojë saktë afatet kohore për adresimin e rekomandimeve të bëra nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, me stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme;
- Të sigurojë se bëhet identifikimi i pengesave në inkasimin e të hyrave dhe krijimin e një plani konkret i cili do të rriste shkallën e realizueshmërisë së të hyrave;
- Duhet të kryejë një vlerësim të detajuar të procesit të Prokurimit dhe kontrollit për të kuptuar se pse dobësitë vazhdojnë të shfaqen dhe të identifikojë veprimet që duhen zbatuar për t'i adresuar këto dobësi;
- Të sigurojë se çdo subvencion bëhet në bazë të planifikimit dhe bazuar në vendimet e organeve kompetente siç e kërkon rregullorja e brendshme. Procesi të bëhet transparent dhe se subvencionet jepen vetëm në bazë të kriterëve adekuate, e përcjellur kjo me plan detal ideor me qëllim që të zvogëlohet mundësia që fondet e ndara të devijojnë nga qëllimi i paraparë;
- Të sigurojë se obligimet e komunës raportohen në baza të rregullta mujore dhe në përputhje me kërkesat e rregullores financiare nr. 02/2013 për obligimet e papaguara;
- Të sigurojë se aktiviteti i ardhshëm i auditimit të brendshëm do të orientohet drejt zhvillimit dhe zbatimit të strategjisë së auditimit të bazuar në rrezik të fokusuar në vitin aktual; dhe
- të bëhet funksionalizimi i punës së komitetit të auditimit.

### **Përgjigja nga Menaxhmenti – auditimi për 2013**

Menaxhmenti është pajtuar me të gjitha gjetjet e auditimit dhe është zotuar se do t'i adresoj rekomandimet tona.

# 1 Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia

Është përgjegjësi e menaxhmentit të përgatis PVF sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik (SNKSP) për “Raportimin Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme” dhe kërkesave të tjera specifike. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (OAG) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e Pasqyrave Vjetore Financiare (PVF) dhe të dhënave tjera financiare si dhe dhënien e opinionëve:

- Nëse PVF japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Ne kemi shqyrtuar shkallën deri në të cilën mund të mbështetemi në kontrollet menaxheriale gjatë përcaktimit të testimit të hollësishëm, të cilat janë të nevojshme për të siguruar nivelin e nevojshëm të dëshmive për të mbështetur opinionin e Auditorit të Përgjithshëm (AP) dhe fokusin e auditimit tonë të pajtueshmërisë.

Pjesët e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit.

Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuar gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato janë konsideruar relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

**Të prioritetit të lartë** – Çështje të cilat mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

**Të prioritetit të mesëm** - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Procedurat tona kanë përfshirë një rishikim të kontrolleve të brendshme dhe sistemeve të kontabilitetit dhe procedurat vetëm deri në atë masë që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive të cilat ekzistojnë, apo edhe të të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë funksionuar. Të gjeturat që konsiderohen si me prioritet të ulët do ti raportohen veçmas stafit të financave.

## 2 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

### **Konkluzioni i përgjithshëm**

Rishikimi ynë i PVF merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të regjistruar në pasqyrat financiare. Ne gjithashtu marrim parasysh deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA) dhe Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF), kur draft PVF-të të dorëzohen në Qeveri.

Deklarata në lidhje me prezantimin e PVF përfshin një numër të pohimeve për sa i përket pajtueshmërisë me kornizën raportuese dhe cilësinë e informacionit në kuadër të pasqyrave financiare. Disa deklaratë kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.



## 2.1 Opinioni i Auditimit

### *Opinion i Pamodifikuar<sup>1</sup> me Theksim të Çështjes*

Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.

Si *Theksim i çështjes* Regjistri i Pasurive Fikse ende nuk është i plotë dhe i saktë, pasi që regjistri i pasurive jokapitale ishte nënvlerësuar për 363,245€. Po ashtu komuna kishte bërë keq klasifikimin e shpenzimeve në vlerë 106,563€, ku nga kodi i kapitaleve, komuna kishte bërë pagesa për subvencione (29,980€) dhe për mallra dhe shërbime (76,583€). Regjistri i pasurive fikse dhe keqklasifikimi ekonomik i shpenzimeve nuk ka ndikim në ndonjërin prej dy Pasqyrave Vjetore Financiare ('Pranimet dhe Pagesat në Para të Gatshme' dhe 'Krahasimi i Buxhetit me Shumat Aktuale'), në pajtim me SNKSP në bazë të kontabilitetit të parasë së gatshme. **(SNISA 200 Opinion i Pamodifikuar me Theksim të Çështjes).**

---

<sup>1</sup> Termi „opinion i pamodifikuar” është ekuivalent me termin „opinion i pakualifikuar” i përdorur në versionin paraprak të Raportit Vjetor. Terminologjia e re është në pajtim me standardet të reja të INTOSAI-t (SNISA 200). Për më tutje referohu në shtojcën I.

---

## 2.2 Rreziqet domethënëse në Pasqyrat Vjetore

### Përshkrimi

Në Memon tonë të planifikimit të auditimit të datës 21/10/2013, janë identifikuar rreziqe domethënëse në PVF lidhur me plotësinë e Pasurive dhe prezantimit të Pagesave nga Palët e treta. Këto janë rreziqe të anomalive materiale, nga të cilat mund të rezultojë një opinion i modifikuar, përfshirë Theksimin e Çështjes.

Rreziku i anomalive materiale që ne kemi identifikuar në lidhje me plotësinë e pasurive dhe paraqitjen e drejtë të Pagesave nga Palët e Treta ka ndodhur për shkak se menaxhmenti nuk kishte ndërmarrë veprime për të adresuar rreziqet e paraqitura.

### Rreziku i identifikuar

#### Çështja 1 - Mos prezantimi i drejtë i Pagesave nga Palët e treta në PVF e komunës

#### E gjetura

Gjatë auditimit të ndërmjetëm ne kemi shqyrtuar kontrollet e menaxhmentit dhe proceset shoqëruese që janë zbatuar për prezantimin e drejtë të pagesave nga palët e treta në PVF dhe kemi dhënë këshilla për t'i përmirësuar ato siç duhet. Rreziku i identifikuar është materializuar sepse menaxhmenti nuk ka arritur t'i bëjë përmirësimet e nevojshme në kontrollin e brendshëm dhe ne kemi konfirmuar që vlerat e pagesave nga palët e treta të prezantuara në PVF janë materialisht të pasakta. Mirëpo, me propozimet tona për korrigjim të gabimeve, komuna kishte adresuar këtë problem duke paraqitur drejtë vlerën e këtyre pagesave në PVF-të finale.

**Rekomandimi 1 Prioriteti i lartë** - Kryetari i Komunës duhet të analizojë arsyet për dështimin në paraqitjen e drejtë të Pagesave nga Palët e treta në PVF-të fillestare dhe të identifikojë veprimin e duhur për t'i adresuar këto dobësi të kontrolleve në mënyrë që të mundësojë një prezantim të drejtë dhe të vërtetë të tyre në vitin 2014.

### Rreziku i identifikuar

#### Çështja 2 - Pasuritë në pronësi e komunës nuk ishin identifikuar dhe regjistruar në mënyrën e duhur

#### E gjetura

Ne i kemi vlerësuar kontrollet e zbatuara nga menaxhmenti për ta dëshmuar plotësinë e të dhënave të pasurive në kontekst të shpenzimeve kapitale për vitin 2013 dhe vitet paraprake. Në Memon e auditimit të ndërmjetëm, ne i kemi dhënë këshilla menaxhmentit për veprimin

---

që nevojitet për të siguruar që shifra e pasurive në PVF të ishte e saktë. Megjithatë, rreziku i identifikuar është materializuar sepse menaxhmenti nuk ka arritur t'i bëjë përmirësimet e nevojshme në kontrollin e brendshëm dhe ne kemi vërejtur se blerje të këtij viti si: kaldaja për shkollat e komunës në vlerë 11,790€, rregullimi i tregut të gjelbër në vlerë 15,000€ dhe stoqe në vlerë 9,670€ nuk ishin paraqitur në regjistrin e pasurisë së komunës. Regjistri i pasurive jokapitale ishte nënvlerësuar për 363,245€. Regjistri i stoqeve nuk përmbante stoqet e sektorit të arsimit dhe atij të shëndetësisë të komunës. Pasuritë jokapitale dhe stoqet nuk procedohen në regjistrin e-pasuria në mënyrë sistematike. Nga kjo kemi konfirmuar që vlerat e pasurive të regjistruara në PVF janë materialisht të pasakta.

**Rekomandimi 2 Prioritet i lartë** - Kryetari i Komunës duhet të analizojë arsyet për mosparaqitje të plotë dhe të drejtë të pasurive në PVF-të e vitit 2013 dhe të identifikojë veprimin e duhur për t'i adresuar këto dobësi të kontrolleve në mënyrë që të mundësojë një prezantim të drejtë dhe të vërtetë të pasurive në vitin 2014.

## 2.3 Pajtueshmëria me kërkesat për raportim në PVF

### Përshkrimi

PVF duhet të jenë në përputhje me kornizën e caktuar raportuese. Ne kemi marrë parasysh dhe nuk kemi asnjë çështje për të ngritur në lidhje me:

- Pajtueshmërinë me RrF nr. 03/2013;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048;
- PVF janë dorëzuar në Ministrinë e Financave (MF) brenda kornizës kohore ;
- PVF janë nënshkruar nga ZKA (Kryetari i Komunës) dhe ZKF;
- PVF janë pranuar në gjuhën shqipe dhe serbe;
- PVF janë përgatitur në kopje fizike dhe elektronike; dhe
- Komuna kishte dorëzuar raporte të rregullta tremujore tek Kuvendi Komunal dhe një kopje tek Ministri i MF gjatë vitit 2013.

Përveç pajtueshmërisë, ne kemi identifikuar disa mangësi në prezantimin e informatave. Në draft pasqyrat financiare ishte e nevojshme që të bëheshin disa korrigjime financiare dhe ne kemi dhënë disa sugjerime për t'u përmirësuar ato.

Pas sugjerimeve tona, disa përmirësime në PVF janë bërë dhe këtë e tregon seksioni 2.2 i këtij raporti, me ç' rast janë korrigjuar Pagesat nga Palët e Treta. Megjithatë disa gabime nuk ishin korrigjuar nga ana e komunës, sikurse përmenden në vazhdim:

### Çështja 3 - Procesi i përgatitjes së PVF-ve - Prioritet i lartë

- E gjetura** Vlera e pasurive e prezantuar në shënimin 30 dhe 31 nuk ishte e saktë. Regjistri i pasurive jokapitale ishte nënvlerësuar për 363,245€.
- Po ashtu, komuna kishte bërë keqklasifikim të shpenzimeve në kategorinë ekonomike investime kapitale në vlerë 106,563€. Nga kjo kategori kishte paguar 29,980€ për subvencione dhe 76,583€ për mallra dhe shërbime.
- Rreziku** Paraqitja jo e saktë e pasqyrave financiare dhe gabimeve në shumat e regjistruara shpie në një keqkuptim të pozitës financiare të komunës dhe ka ndikim potencial negativ në saktësinë e kërkesave të ardhshme buxhetore.
- Rekomandimi 3** Kryetari i Komunës duhet të identifikojë veprimin e duhur për t'i adresuar këto dobësi të kontroleve në mënyrë që të mundësojë një prezantim të drejtë dhe të vërtetë të dhënave në vitin 2014.

## 2.4 Pajtueshmëria me kërkesat e tjera për raportim të jashtëm

### Përshkrim

Përveç hartimit të PVF-ve, komuna kishte përmbushur obligimet për raportim të jashtëm:

- Kërkesa Buxhetore;
- Raportet tremujore, duke përfshirë pasqyrat financiare nëntë mujore me kohë;
- Raportet operative (të performancës); dhe
- Draft plani dhe plani përfundimtar i prokurimit me kohë.

### Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

## 3 Rekomandimet e vitit paraprak

### Konkluzioni i përgjithshëm

Komuna edhe pse me vonesë dhe jo në afatin ligjor të paraparë, kishte dorëzuar në ZAP planin për adresimin e rekomandimeve nga viti paraprak.

Pavarësisht përpilimit të planit të veprimit, shumica e rekomandimeve të dhëna në vitin 2012 kanë mbetur pa u zbatuar, duke ndikuar kështu në përsëritjen e dobësive të njëjta edhe në vitin vijues.

### Përshkrimi

Raporti ynë i auditimit për PVF-të të vitit 2012 të Komunës së Rahovecit kishte rezultuar me (14) katërmbëdhjetë rekomandime.

Deri në fund të auditimit, pesë rekomandime janë adresuar plotësisht, dhe nëntë të tjera nuk janë adresuar ende. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shihni Shtojcën II.

---

### Çështja 4 - Adresimi i rekomandimeve nga viti paraprak - Prioritet i lartë

**E gjetura** Komuna nuk ka zbatuar ndonjë proces formal për të menaxhuar dhe monitoruar mënyrën e zbatimit të rekomandimeve të ZAP-it, dhe si rezultat i kësaj vetëm një pjesë e rekomandimeve të vitit të kaluar ishin adresuar.

**Rreziku** Vonesat në adresimin e rekomandimeve shpien në rrezikun e pranisë së vazhdueshme të dobësive të njëjta dhe ngecjes në kontrollet kyçe që lidhen me rekomandimet përkatëse. Kjo ka ndikuar në mos efikasitet me rastin e mbledhjes së të hyrave dhe menaxhimin e pasurisë, dhe në vlerën e dobët për parandë e shpenzuar.

**Rekomandimi 4** Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që plani i veprimit i rishikuar të përcaktojë saktë afatet kohore për adresimin e rekomandimeve të bëra nga ZAP, me stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme.

## 4 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli

### 4.1 Konkluzioni i përgjithshëm

Qasja jonë e auditimit është fokusuar në të kuptuarit dhe vlerësimin e veprimeve të ndërmarra nga menaxhmenti për të siguruar menaxhim financiar dhe kontroll efektiv dhe të rezultateve nga këto veprime. Për sisteme individuale financiare, ne kërkojmë të identifikojmë nivelin në të cilin operojnë kontrollet aktuale. Ne konsiderojmë se kontrollet janë të dizajnuara mirë, janë zbatuar siç është planifikuar dhe funksionojnë në mënyrë efektive. Kjo kërkon një vlerësim të strukturave, proceseve dhe linjave të llogaridhënies të prezantuara nga menaxhmenti, duke përfshirë rolin e ndërmarrë nga Auditimi i Brendshëm dhe Komitetet e Auditimit.

Ne, gjithashtu, kemi marrë në konsideratë vetë-vlerësimin e komunës të ndërmarrë në kuadër të Menaxhimit të Financave Publike (MFP) në lidhje me vlerësimet e PEFA-s dhe vetë-vlerësimin e KBFP-së.

Ne kemi gjetur se shumica e kontrolleve të vendosura nga ana e komunës kërkojnë përmirësime të mëtejshme. Kontrollet në lidhje me inkasimin e të hyrave dhe një sërë fushash të shpenzimeve kërkojnë përmirësim të mëtejshëm në mënyrë që të parandalojë që komuna të ketë humbje financiare, vlerë të dobët për paranë dhe menaxhim jo efektiv të projektit. Fushat kryesore ku nevojiten më shumë përmirësime janë Planifikimi i Buxhetit, Te hyrat, Prokurimi, Subvencionet dhe Obligimet e papaguara.

## 4.2 Qeverisja e mirë

### Përshkrim

Raportimi financiar i brendshëm në kuadër të komunës është i rregulluar me kornizën ligjore në fuqi. Sidoqoftë, dobësitë në kontrollet e nivelit të lartë të identifikuara sugjerojnë se menaxhmenti nuk po merr informata të duhura që do të ofronin bazë për një qasje aktive të adresimit të këtyre çështjeve apo menaxhmenti nuk po ndërmerr veprimet e duhura për ta bërë këtë.

---

### Çështja 5 - Dobësi në kontrollet e menaxhmentit të lartë

**E gjetura** Rishikimi që ne i kemi bërë kontrollove menaxheriale të zbatuara në sistemin financiar kryesor të komunës ka nxjerrë në pah një raportim të dobët financiar mbi buxhetin dhe shpenzimet tek menaxhmenti i lartë. Kjo ka ndodhur për shkak se formati i raporteve menaxheriale nuk ofron shpjegime rreth fondeve të disponueshme buxhetore kundrejt krijimit të obligimeve. Kjo ka ndikuar që komuna të hyj në obligime të shumta financiare dhe kontraktuale.

**Rreziku** Dobësitë në funksionimin e kontrolleve menaxheriale në sistemin financiar reduktojnë aftësitë e menaxhmentit për të menaxhuar në mënyrë aktive aktivitetet e komunës dhe dëmton kontrollin efektiv buxhetor. Kjo mund të rezultojë në deficit të paplanifikuar si dhe mosarritje të objektivave qeverisëse.

**Rekomandimi 5** Kryetari i Komunës duhet të kryejë një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit tek menaxhmenti i lartë, që të mbështesë menaxhimin efektiv të veprimtarisë dhe të paraqesë zgjidhje të përshtatshme.

## 4.3 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

### Përshkrimi

Në kemi shqyrtuar burimin e fondeve buxhetore për Komunën e Rahovecit, shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike dhe të hyrat e inkasuara. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

**Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore – shpenzimi kundrejt buxhetit (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final <sup>2</sup>	2013 Shpenzimi	2012 Shpenzimi	2011 Shpenzimi
<b>Burimet e Fondeve:</b>	<b>9,774,525</b>	<b>10,384,259</b>	<b>10,067,841</b>	<b>10,276,518</b>	<b>9,965,837</b>
Granti i Qeverisë -Buxheti	8,824,525	9,174,525	9,148,203	9,061,614	8,758,131
Të bartura nga viti paraprak <sup>3</sup> -	-	194,162	188,362	333,620	305,977
Të hyrat vetanake <sup>4</sup>	950,000	950,000	680,000	615,107	633,904
Donacionet e brendshme	-	32	-	-	2,380
Donacionet e jashtme	-	65,540	51,277	266,177	265,445

Buxheti final, krahasuar me buxhetin fillestar, ishte më i lartë për 609,734€. Kjo rritje është rezultat i donacioneve vendore dhe të jashtme në vlerë 65,572€, të hyrave të bartura nga viti paraprak në vlerë 194,162€ dhe me rishikim të buxhetit janë ndarë edhe 350,000€.

Në vitin 2013, komuna ka shpenzuar 97% të buxhet final. Më poshtë jepen shpjegimet për shpenzimet sipas kategorive ekonomike.

<sup>2</sup> Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi që është e përshtatur vazhdimisht nga Ministria e Financave

<sup>3</sup> Të hyrat vetanake të Komunave të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

<sup>4</sup> Të hyrat komunale të planifikuara dhe të mbledhura në vitin aktual që janë përdorur nga entiteti për financimin e buxhetit të vet.



**Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike- shpenzimi ndaj buxhetit (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2013 Shpenzimi	2012 Shpenzimi	2011 Shpenzimi
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:</b>	<b>9,774,525</b>	<b>10,384,259</b>	<b>10,067,841</b>	<b>10,276,518</b>	<b>9,965,837</b>
Pagat dhe Mëditjet	5,365,372	5,365,576	5,330,305	5,361,722	5,151,332
Mallrat dhe Shërbimet	733,893	726,847	693,593	939,328	876,762
Shërbimet komunale	257,260	271,260	271,208	292,565	268,618
Subvencionet dhe Transferet	100,000	100,051	93,845	94,141	123,759
Investimet Kapitale	3,318,000	3,920,525	3,678,890	3,588,762	3,545,366

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë dhënë si në vijim:

- Buxheti final për investimet kapitale ishte rritur për 602,525€ në krahasim me buxhetin fillestar. Rritja ishte si rezultat i të hyrave të bartura nga viti i kaluar në vlerë 194,162€, donacioneve të jashtme 58,363€ dhe vlera 350,000€ ishte ndarë me rishikim për të mbështetur një projekt dyvjeçar të filluar në vitin 2012, për ndërtimin (asfaltimin) e rrugës Fortesë – Celinë. Projekti është ende në vazhdim dhe deri më tani është paguar 90% e punëve të përfunduara;
- Buxheti për mallra dhe shërbime ishte reduktuar me 7,046€. Kjo shumë ishte alokuar për shpenzime komunale. Planifikimi fillestar më i lartë në buxhetin e kësaj kategorie ishte për shkak të shpenzimeve të derivateve të cilat parashikoheshin të jenë më të mëdha, por kjo pritshmëri nuk u materializua dhe shpenzimet gjatë këtij viti ishin 95%e buxhetit final.
- Rritja e buxhetit për shpenzime komunale për 14,000€ është si rezultat i transferimit të mjeteve nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve dhe pjesës tjetër me rishikim të buxhetit. Kjo ishte bërë me qëllim të mbulimit të shpenzimeve komunale, të cilat rezultuan të jenë më të larta se sa parashikimet dhe planifikimet e komunës me buxhetin fillestar për këtë kategori.
- Komuna gjatë vitit 2013 ka pranuar gjithashtu grante nga donatorë të jashtëm, përkatësisht Zyra e Komisionit Evropian në Kosovë në vlerën 65,540€, të cilat ishin alokuar për Investimeve kapitale, konkretisht në implementimin e projektit “Shtigjet e verës dhe zhvillimi i kulturës së verës në jug të Kosovës”. Ndërkohë që ekzekutimi i buxhetit gjatë vitit 2013 për këto donacione ishte vetëm 78% e buxhetit final.
- Asnjë vit të hyrat vetanake nuk shpenzohen në tërësi, si rezultat direkt i mos ekzekutimit të buxhetit, duke pasur parasysh se të hyrat vetanake janë burimi i

fundit financiar i përdorur. Në vitin 2014 vlera e bartur e të hyrave ka qenë mbi 162,000€.

**Tabela 3. Të hyrat vetjake komunale të buxhetuara dhe të mbledhura në 2013 (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2013 Pranimi	2012 Pranimi	2011 Pranimi
Të hyrat vetanake	950,000	950,000	842,364	800,404	888,000

Buxheti i paraparë për realizimin e të hyrave vetanake ishte realizuar rreth 89%. Komuna nuk ka marrë në konsiderim trendin e pranimeve nga vitet e kaluara, p.sh. shkalla e pranimeve në vitin 2011 ishte më e lartë se në dy vitet e fundit.

Në anën tjetër, listat e debitorëve ndaj komunës kanë kaluar shifrën prej 2,2 milion, që paraqet një shumë domethënëse për komunën, dhe gjendja e llogarive të arkëtueshme është në rritje të vazhdueshme.

#### Çështja 6 - Ekzekutimi i buxhetit - Prioriteti i Lartë

**E gjetura** Përkundër shkallës së lartë të ekzekutimit, planifikimi i buxhetit për investime kapitale nuk ishte bërë mirë. Duke i përjashtuar të hyrat vetjake të pa mbledhura, mbi 130,000€ në këtë kategori komuna nuk kishte arrit t'i shpenzoj, ndërkaq në fund të vitit kishte raportuar shuma të mëdha të detyrimeve të pa paguara.

**Rreziku** Planifikimi jo i duhur i buxhetit mund të rezultojë në mos arritjen e objektivave të komunës dhe financimin e detyrimeve të vitit aktual nga buxhetet e vitit të ardhshëm.

**Rekomandimi 6** Kryetari i Komunës duhet të sigurojë se procesit të përgatitjes së buxhetit i paraprinë një rivlerësim i procesit dhe planifikimi bëhet duke u bazuar në parametra të arsyeshëm dhe real.

## 4.4 Të hyrat vetanake

### Përshkrimi

Komuna ka vendosur disa kontrole mbi të hyrat, megjithatë, ekziston nevoja për përmirësime të mëtejshme sidomos në nxjerrjen dhe aplikimin e politikave dhe mekanizmave adekuat në mbledhjen e borxheve të mbetura nga vitet paraprake nga tatimi në pronë, qiratë dhe borxhet tjera. Janë të domosdoshme kontrole më të forta në aplikimin e barazimeve mujore mes departamenteve dhe zyrtarit të të hyrave, ripërtëritjen e kontratave të skaduara për pronat që komuna aktualisht i ka të dhëna me qira, azhurnime në legjislacionin i cili është në përdorim për dhënien e lejeve të ndërtimit dhe në përdorimin e sistemeve elektronike në procesimin e taksave administrative.

Të hyrat e arkëtuara nga Komuna e Rahovecit në vitin 2013 ishin në total 842,364€. Burim i këtyre të hyrave ishin të hyrat nga tatimi në pronë, lejet e ndërtimit, taksat administrative, etj.

---

### Çështja 7 - Planifikim dhe realizim i dobët i të hyrave - Prioritet i lartë

**E gjetura** Komuna për vitin 2013 kishte planifikuar të realizonte 220,000€ të hyra nga tatimi në pronë, ndërkohë që ka arritur të inkasojë 284,945€. Nga kjo shihet një tejkalim i planit vjetor. Bazuar në vitin paraprak ku të hyrat e realizuara kanë qenë 265,460€, vërehet se nuk është bërë një planifikim i mirë, pasi që vlera e planifikuar për vitin 2013 është shumë më e ulët se realizueshmëria e vitit paraprak. Shuma e borxheve të grumbulluar nëpër vite nga tatimi në pronë arrin vlerën 1,391,589€. Komuna nuk ka një plan apo strategji të arkëtimit të këtij borxhi.

Nga lejet e ndërtimit, komuna kishte planifikuar të inkasoj 47,000€, ndërsa kishte realizuar 24,185€ apo 51% të tyre.

Vlera e faturuar e objekteve të dhëna me qira ishte 47,246€ ndërkohë nga kjo shumë komuna ka arritur të inkasojë 38,248€ apo 81% të vlerës së faturuar. Shuma e borxheve të grumbulluar nëpër vite nga qiratë e objekteve komunale është 139,525€. Tek marrëveshjet për qiradhënie me kompanitë: NT Ganex kemi vërejtur se kjo kompani nuk ka bërë asnjë pagesë gjatë vitit 2013, ndërkohë që ka borxh 53,377€; kompaninë NP Frigo Star, e cila ka paguar vetëm 3,000€, ndërsa borxhi i saj ishte 15,560€; kompaninë NT "Xeni Comerc" e cila gjatë këtij viti ka paguar vetëm 1,512€, ndërsa ka borxhe në vlerë 8,127€; dhe kompaninë "Sh.p.k Moderne" e cila nuk kishte bërë asnjë pagesë për këtë vit ndërsa ka borxhe në vlerë 6,300€

**Rreziku** Politikat e dobëta të planifikimit dhe realizimit të të hyrave mund të rrezikojnë sigurimin e maksimizimit të të hyrave dhe arritjen e objektivave të parapara për këtë periudhë.

**Rekomandimi 7** Kryetari i Komunës të sigurojë se buxheti i të hyrave bëhet mbi bazën e një planifikimi të mirëfilltë dhe të bazuar në parametra real. Po ashtu të bëhet identifikimi i pengesave në inkasimin e të hyrave dhe krijimin e një plani konkret i cili do të rriste shkallën e realizueshmërisë së të hyrave. Menaxhmenti duhet të ndërmerri veprime të menjëhershme lidhur me kontratat e pronave të dhëna me qira dhe inkasimin e borxheve të mbetura. Në të kundërtën, kontratat duhet të ndërpriten dhe shfrytëzimi i pronave publike të ndalohej.

#### **Çështja 8 - Kalkulime të pasakta dhe mosrespektim i ligjit me rastin e dhënies së lejeve ndërtimore- Prioriteti i lartë**

**E gjetura** Në dy raste, komuna kishte bërë kalkulime jo të sakta gjatë përcaktimit të ngarkesave për përfituesit e lejeve ndërtimore, duke rezultuar kështu me ngarkesë totale më të vogël për 490€ nga ajo që ishte paraparë me rregulloren për përcaktimin e tarifave dhe ngarkesave të komunës.

Po ashtu, me rastin e dhënies së lejeve ndërtimore nuk aplikon ligjin e ri të ndërtimit nr. 04/L - 110 të aprovuar në Maj 2013, por vazhdon të aplikojë rregulloren e brendshme.

**Rreziku** Rastet e ngarkesave më të vogla se sa shifrat e dhëna gjatë kalkulimeve të tarifave për lejet e ndërtimit, rezultojnë me humbje financiare për komunën.

**Rekomandimi 8** Kryetari i Komunës të sigurojë se të gjithë përfituesit e lejeve ndërtimore të ngarkohen me shuma të sakta dhe konform ligjit të ndërtimit.

## **Çështja 9 - Mangësi në kontratat dhe faturimet e qiradhënies së objekteve komunale- Prioriteti i lartë**

**E gjetura** Në një rast komuna kishte lidhur kontratë për shfrytëzim të pronës komunale në vitin 2008 me NT Ganex dhe i njëjti vazhdon të shfrytëzojë pronën komunale edhe pse nuk ka kontratë për tërë vitin 2013.

Gjatë vitit 2013, komuna kishte nënshkruar marrëveshje katërvjeçare të qiradhënies së kafenesë në parkun e qytetit, duke mos specifikuar në këtë marrëveshje bartësin e shpenzimeve komunale të operimit të kësaj kafeneje. Si rezultat, komuna është dashur të mbulojë të gjitha këto shpenzime të cilat për vitin 2013 ishin në vlerë 5,745€, ndërkohë që qiraja vjetore nga ky subjekt ishte 2,460€, duke shkaktuar humbje financiare komunës në vlerë 3,285€, në vend të përfitimeve nga kontrata për qira.

Më tej, faturimet për ngarkesat e të gjithë shfrytëzuesve të pronave të komunës nuk ishin bërë në baza mujore.

**Rreziku** Mungesa e kontratës për pronat që komuna i ka të dhëna me qira rrit rrezikun e arkëtimit të këtyre borxheve nga ana e komunës. Marrëveshjet e qiradhënies me përmbajtje të paqartë, rrezikojnë humbjen financiare të vazhdueshme për komunën.

**Rekomandimi 9** Kryetari i Komunës të sigurojë se do të bëhet ripërtëritja e kontratave të skaduar dhe faturimi i subjekteve në baza të rregullta mujore. Më tutje, komuna duhet të bëjë qartësimin e të gjitha marrëveshjeve komerciale dhe të anuloi kontratat e pa favorshme për komunën.

## Çështja 10 - Mangësi në procesimin dhe raportimin e të hyrave - Prioriteti i lartë

**E gjetura** Komuna nuk ka të instaluar sistemin e ri për procesimin e pagesave të taksave administrative. Qëllimi i këtij sistemi është që të gjitha pagesat nën 10€ që bën qytetari për shërbimet e ofruara nga komuna, të regjistrohen në një bazë duke larguar bllok dëftesat.

Barazimet mujore në mes të zyrtarit të hyrave dhe departamenteve të komunës nuk bëhen në baza të rregullta, e që janë të domosdoshme për të shmangur diferencat eventuale dhe për të siguruar efikasitet në raportimin e të hyrave.

**Rreziku** Mospërdorimi i sistemit për procesimin e pagesave nga taksat administrative dhe mosbarazimet mujore mes zyrtarit të të hyrave dhe departamenteve të komunës rrezikojnë saktësinë dhe plotësinë e raportimit të të hyrave.

**Rekomandimi 10** Kryetari i Komunës të sigurojë se procesimi i pagesave nga taksat administrative të bëhet përmes sistemit elektronik dhe të aplikohen barazime mujore në mes të departamenteve përkatëse dhe zyrtarit të të hyrave. Procesi si i tillë, duhet të monitorohet në baza të rregullta.

## 4.5 Shpenzimet

### 4.5.1 Prokurimi

#### Përshkrimi

Blerjet e realizuara nëpërmjet procedurave të prokurimit për vitin 2013 ishin 6,182,115€. Një numër i kontratave ishin të tipit kornizë e që vlera e tyre është e ndryshueshme, pasi që ajo bazohet në çmimet për njësi dhe furnizimet mund të shtohen ose zvogëlohen.

Ne kemi testuar 24 njësi mostre prej 3,922,889€ me objektivin se si janë zhvilluar procedurat dhe 59 njësi mostre që kapin vlerën 1,609,079€. Gjetjet tona janë përshkruar në vijim të këtij raporti.

Ne kemi analizuar nëse projektet për investime kapitale kanë qenë të përfshira në Programin për Investime Publike (PIP) dhe në kornizën afatmesme të shpenzimeve. Gjithashtu, kemi rishikuar nëse ka ndodhur ndonjë ndryshim gjatë vitit lidhur me projektet e parapara. Ne kemi vërejtur dobësi në menaxhimin e PIP nga ana e komunës dhe i kemi paraqitur ato në vazhdim.

## Çështja 11 - Dobësi sistematike në prokurim - Prioritet i lartë

**E gjetura** Komuna nuk kishte respektuar rregullat financiare dhe të prokurimit në shumë raste:

Në dymbëdhjetë raste ka hyrë në obligime më shumë se sa ndarjet buxhetore për projekte të caktuara. Shuma e ndarjeve buxhetore për këto projekte për tri vite ishte 2,213,266€, ndërsa vlera e kontratave të lidhura për realizimin e këtyre projekteve ishte 6,167,076€. Deficitet buxhetore për këto projekte arrijnë vlerën 3,953,810€;

Komuna nuk mirëmban dhe azhurnon Programin e Investimeve Kapitale. Në katërbëdhjetë raste, ne kemi vërejtur se komuna nuk kishte bërë azhurnimet e duhura në PIP me rastin e ndryshimit të vlerës së kontratës nga vlera e buxhetuar e atyre projekteve, katër projekte nuk ishin fare të evidentuara në PIP, si dhe nuk bëhet raportimi i progresit të këtyre projekteve;

Në katër raste komuna kishte shpërblyer me kontratë operatorët e papërgjegjshëm, të cilët nuk kanë plotësuar kriteret e dosjes së tenderit.

Në katër kontrata, sigurimi i ekzekutimit të punimeve nuk mbulon periudhën e implementimit të kontratës;

Në gjashtë raste dosja e tenderit kërkonte sigurimin e tenderit në vlerë 1,000€ dhe jo vlerën 3% apo maksimum 5% të vlerës së parashikuar të projektit, siç kërkohet me rregullat ligjore;

Komuna është e obliguar që të bëjë njoftimin me shkrim të Operatorëve Ekonomik (OE-ve) të eliminuar apo të pasuksesshëm, duke shpjeguar arsyet për vendimin e marrë. Komuna, në katërbëdhjetë raste nuk kishte bërë këtë njoftim për operatorët.

**Rreziku** Kontraktimi pa fonde të mjaftueshme rezulton me obligime dhe e ndikon buxhetin dhe objektivat e vitit të ardhshëm. Mos azhurnimi i PIP do të zvogëlojë zbatimin efektiv të planeve të parapara të shpenzimeve kapitale. Mos njoftimi i OE të eliminuar rrezikon transparencën e procesit. Mos vazhdimi i afateve të sigurisë së ekzekutimit rrezikon përfundimin e projekteve sipas kontratës.

**Rekomandimi 11** Kryetari i Komunës duhet të kryejë një rishikim të brendshëm për të përcaktuar pse kërkesat e prokurimit nuk janë adresuar në të gjitha rastet e prokurimit dhe të ushtrojë më shumë kontrolle për të siguruar se dobësitë sistematike të identifikuara janë adresuar.

## Çështja 12 - Dobësitë jo-sistematike të prokurimit - Prioritet i lartë

**E gjetura** Komuna kishte paguar 3,296€ për “Dezinfektim të zonave selektive, vatrave të prekura nga ethet hemorragjike” pa respektuar procedurat e prokurimit. Përzgjedhja e kompanisë fituese ishte bërë përmes nënshkrimit të një marrëveshje mirëkuptimi ndërmjet Kryetarit të Komunës dhe kompanisë përkatëse.

Kryetari i Komunës kishte marrë vendim që t’i lejohen mjete financiare operatorit ekonomik Grafix në vlerë 4,500€ në emër të shpenzimeve për organizimin e festivalit folklorik, pa i përfillur procedurat e prokurimit.

Komuna kishte bërë blerjen e gjashtë llaptopëve për nevoja të anëtarëve të Komitetit për Politikë dhe Financa, pa zbatuar procedura të prokurimit. Kjo blerje ishte bërë në bazë të një memorandum bashkëpunimi të nënshkruar midis Drejtorit për Buxhet dhe Financa dhe NTP Sinkopa në vlerë prej 3,127€. Përveç kësaj, marrëveshja nuk kishte përcaktuar specifikat e llaptopëve, sasinë dhe kushtet tjera për liferim.

Tek kontrata “Ndërtimi i rrugëve me kubëza betoni në fshatin Krushë e Madhe” në vlerë 210,538€, komuna kishte shpërblyer me kontratë OE i cili në dosjen e tij kishte prezantuar një nënkontraktor me pjesëmarrje prej 66% të vlerës së ofruar. Kjo është në kundërshtim me Ligjin për prokurim publik (LPP) i cili lejon vlera e nën kontraktuar të jetë maksimalisht deri në 40% të vlerës së kontratës

**Rreziku** Shmangia nga procedurat e prokurimit rrezikon cilësinë e punëve apo mallrave të pranuar. Pagesat për mallrat me çmime më të mëdha se sa oferta e kontraktuar, rrit rrezikun për humbje të konsiderueshme financiare të komunës.

**Rekomandimi 12** Kryetari i Komunës duhet të shqyrtojë pse kërkesat e prokurimit nuk janë zbatuar me konsistencë në rastet e mësipërme dhe të ushtrojë më shumë kontrolle për të siguruar që një situatë e tillë nuk do të përsëritet.



## 4.5.2 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)

### **Përshkrimi**

Pagat dhe Mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar qeveritar. Kontrollat që operojnë në nivel lokal nga komuna kanë të bëjnë me: a) autorizimin e listës së pagave; b) verifikimin e ndryshimeve të mundshme; dhe c) rishikimin e buxhetit për këtë kategori dhe barazimet me thesarin.

Ne kemi testuar 33 mostra për të verifikuar nëse ekziston pajtueshmëri midis listës së pagave me sistemin e payrollit, procedurat e rekrutimit dhe rregullsinë e dosjeve të personelit. Në lidhje me këto ne nuk kemi konstatuar ndonjë parregullsi për tu raportuar.

### **Rekomandim**

Ne nuk kemi rekomandim në këtë fushë.

## 4.5.3 Subvencionet dhe Transferet

### **Përshkrimi**

Komuna për vitin 2013 kishte planifikuar shumën prej 100,051€ për subvencione dhe transfere, ndërsa kishte shpenzuar 93,845€.

Gjatë këtij viti komuna ka përpiluar një rregullore të brendshme e cila rregullon ndarjen e subvencioneve, mirëpo shumica e subvencioneve ishin dhënë para se e njëjta të aprovohej. Kjo ka ndikuar që subvencionet të shpërndahen pa kritere të paracaktuara, duke rrezikuar kështu qëllimin për të cilin janë dedikuar.

### **Çështja 13 – Shpërndarja e subvencioneve pa dokumentacion mbështetës - Prioritet i lartë**

**E gjetura** Komuna kishte bërë shpërndarjen e 81 bursave për student në vlerë 40,500€, të cilat nuk ishin të planifikuara me ndarjet buxhetore nga drejtoria e arsimit. Këto mjete ishin marr nga drejtoria e shëndetësisë. Për këtë subvencionim nuk kishte ndonjë vendim nga Kryetari apo Kuvendi.

Kryetari i Komunës kishte marrë vendim të ndajë mjete në vlerë 5,000€ për përkrahjen e organizimit të festivalit “Nine Eleven Festival”. Përfituesi nuk kishte sjell raporte dhe dëshmi për realizimin e festivalit dhe nuk kishte as ndonjë raport monitorimi të këtij aktiviteti nga ana e komunës.

Subvencionime tjera ishin bërë për Klubin futbollistik “Rahoveci” në vlerë 1,500€, Shoqatën kulturore “Anadrinia” për organizim të festivalit “Anadrinia Jehon 2013” 2,000€, si dhe Shoqatën kulturore “Bajram Curri” nga Krusha e Madhe 1,500€. Subvencionet ishin dhënë pa dokumente mbështetëse, si; certifikata e regjistrimit, arsyetimi i qartë i kërkesave të aplikantëve, si dhe informatat vjetore mbi aktivitetin dhe qarkullimin financiar, të cilat kërkohen me rregulloren e brendshme. Po ashtu, komuna nuk ka bërë monitorim e aktiviteteteve për asnjë nga përfituesit.

**Rreziku** Dhënia e subvencioneve pa vendime të organeve kompetente, mos përfillja e kriterëve të rregullores së brendshme si dhe subvencionimi i studentëve pa konkurs publik, janë disa nga mangësitë që rrisin rrezikun e transparencës së procesit dhe që fondet të mos jenë shpenzuar në pajtim me qëllimet e dedikuara.

**Rekomandimi 13** Kryetari i Komunës duhet të sigurojë se çdo subvencion bëhet në bazë të planifikimit dhe me vendim të organeve kompetente, siç përcakton rregullorja e brendshme, procesi të bëhet transparent dhe se subvencionet të jepen vetëm në bazë të kriterëve adekuate, e përcjellur kjo me plan të hollësishëm ideor me qëllim që të zvogëlohet mundësia që fondet e ndara të devijojnë nga qëllimi i paraparë.

## 4.6 Pasuritë dhe detyrimet

### 4.6.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

#### **Përshkrim**

Auditimi ynë ka vërejtur një angazhim nga ana e komunës në regjistrimin e pasurive të saj në SIMFK. Gjendja e pasurisë kapitale në vitin e kaluar ishte 88,750,211€, ndërsa vlera e pasurisë në fund të vitit 2013 është rritur në 89,129,220€. Pavarësisht këtyre përpjekjeve komuna ende nuk ka kontrolle të mjaftueshme në lidhje me pasurinë e saj kapitale. Mungesë e kontrolleve nga ana e komunës vërehet edhe në menaxhimin dhe regjistrimin e pasurisë nën 1,000€.

Përveç çështjeve të ngritura për pasuritë në këtë kapitull, të dhënat në lidhje me plotësinë e tyre janë të përshkruara në kapitullin 2.2- Rreziqet domethënëse në PVF.

---

#### **Çështja 14 - Dobësi në menaxhimin e pasurive - Prioriteti i lartë**

**E gjetura** Komuna gjatë vitit 2013 nuk kishte formuar komisionin për inventarizimin dhe vlerësimin e pasurisë së saj, siç kërkohet me Rregulloren 02/2013 për menaxhim të pasurisë jo financiare.

**Rreziku** Mungesa e kontrolleve në menaxhimin e pasurisë dhe mos regjistrimi i saj sipas rregullave mund të shpie në humbjen, keqpërdorimin dhe përdorimin e paautorizuar të tyre.

**Rekomandimi 14** Kryetari i Komunës duhet të sigurojë se komisionet e inventarizimit dhe vlerësimit të pasurisë përfundojnë punën e tyre dhe raportojnë me kohë. Zyrtari për menaxhim të pasurisë duhet të regjistrojë dhe mirëmbajë regjistrat e pasurisë sipas Rregullores 02/2013 për menaxhim të pasurisë jo financiare.

## 4.6.2 Trajtimi i borxheve

### Përshkrim

Pasqyra e detyrimeve të papaguara ndaj furnizuesve në fund të vitit 2013 ishte 2,202,988€. Krahasuar me vitin 2012 ku shuma e obligimeve ishte në vlerë 56,807€, rritja në këtë vit ishte mbi 2.1 milionë euro. Shuma e lartë e obligimeve të papaguara kryesisht është si rezultat i hyrjes në kontrata nga ana e komunës pa pasur buxhet të mjaftueshëm për realizimin e atyre kontratave. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2014. Problemi që ka komuna me obligime është trajtuar edhe te kapitulli 4.5.1 i këtij raporti.

---

### Çështja 15 - Mos raportim i obligimeve - Prioritet i lartë

**E gjetura** Komuna nuk kryen raportime të rregullta mujore në MF për obligimet e papaguara, siç kërkohet me Rregullën financiare për obligimet e papaguara.

**Rreziku** Mos raportimi i rregullt dhe me kohë i obligimeve rrezikon që komuna mos të jetë e vetëdijshme për obligimet e saj me kohë dhe të hyn në obligime të mëtejme, duke rrezikuar kështu buxhetin dhe realizimin e objektivave të vitit të ardhshëm.

**Rekomandimi 15** Kryetari i Komunës të sigurojë se obligimet e komunës raportohen në baza të rregullta mujore dhe në përputhje me kërkesat e Rregullës financiare për obligimet e papaguara.

## 4.7 Sistemi i auditimit të brendshëm

### Përshkrimi

Sistemi i auditimit të brendshëm është një pjesë kyçe e kontrollit të brendshëm dhe për shkak të rëndësisë së tij, ne e prezantojmë këtu veçmas. Ne e marrim parasysh fushëveprimin e punës së auditimit të brendshëm dhe aktivitetet e Komitetit të Auditimit. Përveç kësaj, ne i shqyrtojmë veprimet e ndërmarra nga menaxhmenti i lartë, si rezultat i punës së kryer nga auditimi i brendshëm dhe komiteti i auditimit.

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) ka një plan vjetor të auditimit. Gjatë vitit 2013 ka kryer pesëmbëdhjetë auditimet e parapara për vitin 2013. Shtatë nga pesëmbëdhjetë raportet e kryera (47% e punës së NJAB) ishte e fokusuar dhe mbulonte vitin 2012. Raportet, meqenëse në numër kanë qenë mjaft të larta por ka munguar kualiteti i duhur në identifikimin dhe trajtimin e çështjeve të caktuara. Funksionalizimi i punës së komitetit të auditimit është i domosdoshëm për të mbështetur NjAB në punën e tyre dhe të ndihmojë menaxhmentin në forcimin e kontrolleve të brendshme të komunës

---

### Çështja 16 - Mungesa e cilësisë në raporteve e NjAB dhe mosfunksionim i komitetit të auditimit - Prioritet i lartë

**E gjetura** Raportet e NjAB kishin mangësi në identifikimin dhe trajtimin e çështjeve (problemeve) kryesore me të cilat ishte ballafaquar komuna. NjAB nuk kishte trajtuar si duhet problemet si: obligimet e papaguara, prokurimin, subvencionet etj. për t'i mundësuar menaxhmentit në parandalimin e mangësive të shfaqura gjatë vitit. Komuna kishte të formuar një komitet të auditimit, mirëpo i njëjti nuk kishte funksionuar gjatë vitit 2013.

**Rreziku** Mungesa e cilësisë së raporteve të NjAB dhe fokusimi i punës më shumë në vitin e kaluar, rrezikon parandalimin e mangësive. Mosfunksionimi i komitetit të auditimit rrit rrezikun e operimit efektiv të NjAB.

**Rekomandimi 16** Kryetari i Komunës duhet të sigurojë se NjAB në të ardhmen duhet të orientohet drejt zhvillimit dhe zbatimit të strategjisë së auditimit të bazuar në rrezik të fokusuar në vitin aktual. Kjo do t'i jepte menaxhmentit siguri vjetore për sa i përket efektivitetit të sistemeve të kontrollit të brendshëm. Duhet të bëhet funksionalizimi i punës së komitetit të auditimit.

## Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP

(e shkëputur nga ISSAI 200)

### Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë anomali materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

### Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale. Auditorët mund të japin tre lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- Natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë anomali materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë anomali materiale; dhe
- Gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomali, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomali, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban anomali materiale në pasqyrat financiare, auditori

duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i Theksimit të Çështjes duhet:

- Të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- Të ketë titullin 'Theksim i Çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- Të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen;
- Të tregojë se opinionin e auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.



## Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Rekomandimet plotësisht të adresuara	Rekomandimet pjesërisht të adresuara	Rekomandimet e pa adresuara
2. Pasqyrat Financiare	Kryetari i Komunës duhet të sigurojë se plani sistematik i përpilimit të pasqyrave financiare inkorporon kërkesën për të përfshirë tërë vlerën e pasurive. Kryetari ka nevojë të monitoroj zbatimin e kësaj kërkesë.			Nuk janë marrë masa
3. Rekomandimet e vitit paraprak	Kryetari i Komunës duhet të sigurojë një plan veprimi për adresimin e rekomandimeve të ZAP që në mënyrë të qartë përcakton një afat kohor dhe anëtarët e stafit llogaridhënës, të identifikuar - me fokus fillestar në ato të një rëndësie të madhe.	PO		
4.4 Te hyrat	Kryetari i Komunës duhet të ketë një qasje gjithëpërfshirëse në trajtimin e të hyrave, si në kuptimin e planifikimit ashtu edhe në vendosjen e mekanizmave efektiv për realizimin e parametrave të planifikuar. Kryetari duhet të inicioj një proces rivlerësimi, ku të gjitha llogaritë do të analizohen në kuptimin e vjetërsisë, shumave domethënëse, mundësive reale për inkasim dhe ushtrimin e masave administrative (nëse ka nevojë).			Nuk janë marrë masa
4.4 Te hyrat	Kryetari i Komunës duhet t'i shqyrtoj këto kontrata dhe të insistoj inkasimin e borxheve të mbetura. Në të kundërtën, kontratat duhet të ndërpriten. Një rishikim i vazhdueshëm i kontratave dhe forcimi i kontrolleve duhet të bëhet nga menaxhmenti.			Nuk janë marrë masa

4.5.1 Prokurimi	Kryetari i Komunës duhet të siguroj se buxheti do të realizohet në pajtim me aprovimet paraprake dhe të gjitha shpenzimet do të bëhen sipas kategorive përkatëse buxhetore. Në të kundërtën, duhet ndjekur procedurat normale buxhetore për transfere prej një kategorie ekonomike në tjetrën. Gjithashtu, duhet ndjekur procedurat e prokurimit dhe raportimit nga ana e shfrytëzuesve.			Nuk janë marrë masa
4.5.1 Prokurimi	Kryetari i Komunës duhet të siguroj se shërbimi i prokurimit administron procesin e prokurimit në bazë kërkesave ligjore, përgjatë të gjitha fazave, duke respektuar të gjitha kriteret e parashikuara me dosjen e tenderit.			Nuk janë marrë masa.
4.5.1 Prokurimi	Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që të gjithë tenderuesit e eliminuar, të njoftohen me kohë dhe në mënyrën e paraparë me legjislacion duke iu shpjeguar edhe të drejtat dhe mundësitë për ankim. Njoftimi i OE është kërkesë ligjore, dhe si i tillë duhet zbatuar nga shërbimi i prokurimit.			Nuk janë marrë masa
4.5.1 Prokurimi	Kryetari i Komunës duhet të siguroj se komisionet për vlerësimin e ofertave të formohen brenda afateve të përcaktuara, menjëherë pas procesit të hapjes së ofertave.	PO		
4.5.2. Kompensimet ( pagat dhe mëditjet)	Kryetari i Komunës përmes mekanizmave të vetë duhet ta bëjë një shqyrtim sistematik të dosjeve të personelit për të siguruar se i tërë dokumentacioni dhe ndryshimet e nevojshme janë përfshirë, brenda periudhës së specifikuar kohore. Kryetari duhet të rishqyrtoj rastin nëse pagesat ishin të bazuara.	PO		

4.5.2. Kompensimet ( pagat dhe mëditjet)	Kryetari i Komunës duhet të siguroj se me rastin e rekrutimit të personelit, procesi i rekrutimit të jetë objektiv dhe transparent, duke synuar që të pranohet stafi sa më cilësor dhe më i përshtatshëm për komunën.	PO		
4.6 Subvencionet dhe Transferet	Kryetari i Komunës duhet që të sigurojë se do të hartohet një Rregullore që specifikon qartë kriteret, procedurat dhe burimet e subvencioneve.	PO		
4.6 Subvencionet dhe Transferet	Kryetari i Komunës duhet që të siguroj se janë vendosur kontrole të duhura për shpenzimet e subvencioneve, në pajtim me ndarjet fillestare.			Nuk janë marrë masa
4.6.1. Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	Kryetari i Komunës duhet të inicioj një proces sistematik të regjistrimit të pasurive. Kryetari duhet të siguroj që sa më parë të formoj një komision i cili do të bënte vlerësimin dhe inventarizimin e drejtë dhe të plotë të të gjithë pasurive fikse që janë në pronësi të komunës si dhe të monitoroj rezultatet e vlerësimit.			Nuk janë marrë masa
5. Sistemi i auditimit të brendshëm	Kryetari i Komunës duhet të bëjë plan veprimi dhe të përcaktoj se si gjetjet dhe rekomandimet e dhëna nga auditimi i brendshëm të adresohen nga të gjitha nivelet e menaxhimit si dhe NJAB-i të fokusohet më shumë në auditimet për vitin aktual.			Nuk janë marrë masa